



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Elbasan, më 03.04.2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Blerje kapakë pusetash për ujërat e bardha”

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : Mbulesa pusetash 44423740-0 ; Kapakë 44618340-0

VLERA E FONDIT LIMIT - 1,666,568 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa T.V.SH.

Argumentimi për përlogaritjen e fondit limit : Bazuar në Nenin 76 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 1, me anë të shkresës 162/2 datë 31/03/2026, bazuar në të dhënat e “Sistemit të Integruar të Manualit të çmimeve në ndërtim” Nr. Analize, për tre nga zërat e preventivit ndërsa bazuar në Nenin 76 pika 1/b përmes studimit të tregut, për tre zëra të preventivit, komisioni i ngarkuar, ka bërë përlogaritjen vlerës së prokurimit .

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane, Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë: **Shtojca 7.**

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT / KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

a. Formular Oferte sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Kriteri është vendosur referuar nenit 29 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b.Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore përgjate tre viteve të fundit financiare 2023, 2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar.**

Kriteri **2.2.1** është vendosur referuar nenit 43 pika 1,2,3 dhe nenit 55 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri **2.2.2** eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20%e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik".

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë çertifikatë ISO 9001 – 2015 "Mbi menaxhimin e cilësisë", ose ekuivalente për mallin objekt prokurimi.

Çertifikata e mësiperme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri **2.3.2** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika 6 gërma (c) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik ofertues të jetë i pajisur me çertifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që ky OE do të ofertojë produkte të çertifikuara të një cilësie të mirë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga DPA.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë një automjet të përshtatshëm me kapacitet mbajtës, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme :

-Aktin e pronësisë së mjetit përkatës

Ose

-Kontratën materiale të marrjes me qera të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo me qera) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 2.3.3 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

-Automjeti i përshtatshëm me kapacitet mbajtës do të shërbejë për transportin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike të kapakëve të pusetave për ujërat e bardha janë hartuar përgjegjësi i sektorit teknik dhe mekanik, në strukturën e Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane, Bashkia Elbasan. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT